

Shqipëria në krye të Presidencës së ICIC, Komisioneri Dervishi: Besim që na nderon dhe na motivon



Shqipëria zgjidhet në mënyrë unanime në krye të Presidencës së Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) për periudhën 2025-2027. Zgjedhja në këtë rol të rëndësishëm ndërkombëtar përbën një njohje të qartë të përkushtimit dhe profesionalizmit të institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Rezultatet e votimit të anëtarësisë së organizatës u bënë publike në përfundim të punimeve të edicionit të 16-të të ICIC, të mbajtur në Berlin të Gjermanisë, në datat 23-25 qershor 2025. Në fjalën e tij, Komisioneri, Besnik Dervishi, shprehu mirënjohjen për besimin e dhënë nga anëtarët e forumit: “së pari dëshiroj t’ju falënderoj thellësisht që na besuat sërish ne për të vijuar si Presidencë dhe Sekretariat për periudhën 2025-2027. Kemi ndarë sfida dhe eksperiencë, kemi identifikuar objektiva të përbashkëta dhe kemi rikonfirmuar rolin e pakontestueshëm që e drejta për informim luan në ndërtimin e shoqërive të hapura dhe të qëndrueshme.” Zgjedhja e Shqipërisë në krye të ICIC konfirmon rolin në rritje të vendit tonë në arenën ndërkombëtare si dhe konsolidimin e transparencës dhe qeverisjen e mirë.



“Aksesi në informacionin mjedisor në epokën digjitale” – Konferenca e 16-të e ICIC



Me temë kryesore “Aksesi në informacionin mjedisor në epokën digjitale”, u zhvillua në data 23-25 qershor 2025 edicioni i 16-të i ICIC, me fokus sjelljen në qendër të vëmendjes për publikun të rëndësisë së informimit për çështje që lidhen me mjedisin, në një kohë kur teknologjia dhe të dhënat luajnë një rol gjithnjë e më të madh në vendimmarrje dhe ndërgjegjësim qytetar. Kjo është ngjarja më e rëndësishme ndërkombëtare vjetore dhe mbledh përfaqësues të institucioneve të pavarura, organizatave të shoqërisë civile dhe ekspertë të të drejtës së informimit nga mbarë bota, për të diskutuar çështje kyçe që lidhen me transparencën, llogaridhënien dhe aksesin e qytetarëve në informacionin me karakter publik.



E drejta për informim përballet me kërcënime dhe sfida, veçanërisht sa i përket informacionit mjedisor, të cilave duhet t'u japim zgjidhje specifike. Duhet të forcojmë transparencën dhe të ardhmen e qëndrueshme sepse e drejta për informim është bazë për demokracinë dhe katalizator për ndryshim pozitiv”.

Punimeve të Konferencës iu drejtuan edhe znj. Rita Schëarzelühr-Sutter, Sekretare Shteti në Ministrinë e Mjedisit të Gjermanisë dhe Guilherme Canela de Souza Godoi, Drejtor i Departamentit për Përfshirjen Digjitale, UNESCO. Zyrtarja e lartë gjermane u shpreh se “autoritetet publike që prodhojnë dhe mbajnë të dhëna dhe informacion mjedisor kanë përgjegjësinë të jenë më transparente dhe t'i publikojnë këto të dhëna në mënyrë sa më miqësore për publikun. Informacioni duhet të jetë i thjeshtë, i kuptueshëm dhe i qasshëm për të gjithë.”

Ndërsa përfaqësuesi i UNESCO-s vuri në dukje se “po jetojmë një moment të rëndësishëm, por jo të lehtë, ku themelet e institucioneve të llogaridhënies janë nën sulm – dhe kjo përbën kërcënim për vetë funksionimin e demokracisë. Që demokracia të funksionojë, kërkohen autoritete të pavarura që punojnë, një media e lirë dhe një shoqëri civile aktive.”

Komisioneri Dervishi, në cilësinë e Presidentit të Komitetit Ekzekutiv të ICIC, në fjalën përshëndetëse në nisje të punimeve të Konferencës, theksoi se “e drejta për informim është oksigjeni i demokracisë – ajo që mban gjallë llogaridhënien, pjesëmarrjen qytetare dhe ndërtimin e besimit”. Po ashtu, ai nënvizoi se transparenca nuk duhet të mbetet një koncept teorik, por të funksionojë si një mekanizëm real dhe i qëndrueshëm për të afruar institucionet publike me qytetarët, veçanërisht në fushat që prekin drejtpërdrejt jetën e përditshme, si mjedisi dhe shërbimet publike.

Ndërsa Prof. Dr. Louisa Specht-Riemenschneider, Komisionerja Federale e Gjermanisë për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Lirinë e Informacionit, përmendi në fjalën e saj krijimin e ICIC në Berlin 22 vite më parë dhe vuri në dukje rolin e kësaj organizate. “ICIC është një platformë unike për të shkëmbyer ide dhe përvoja.

Programi i Konferencës përfshiu panele të shumta tematike mbi rolin e teknologjisë në përmirësimin e transparencës; sfidat e institucioneve në garantimin e qasjes në informacionin mjedisor; përfshirjen e shoqërisë civile në këtë proces dhe ndarjen e praktikave të mira midis institucioneve homologe. Në sesionin përmbyllës të Konferencës së ICIC u diskutua mbi zhvillimet e fundit në fushën e të drejtës për informim sipas kontinenteve, u trajtuan çështje të organizimit të brendshëm të organizatës, u konfirmua mbajtja e edicionit të 17-të të Konferencës në Sierra Leone gjatë vitit 2026 dhe u anonçua zgjedhja e Kanadasë si vendi mikpritës i edicionit të 18-të në vitin 2027, u prezantuan konkluzionet e Grupeve të Punës të organizatës, si edhe u shpallën rezultatet e votimit për Presidencën dhe Komitetin Ekzekutiv të ICIC 2025-2027.

Komisioneri Besnik Dervishi takim me homologen gjermane znj. Specht-Riemenschneider



Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, në kuadër të pjesëmarrjes në Konferencën Ndërkombëtare të Komisionerve të Informimit zhvilloi një takim bilateral me Komisioneren Federale të Gjermanisë për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Lirinë e Informacionit, znj. Louisa Specht-Riemenschneider.

Dy Komisionerët shprehën kënaqësinë reciproke për marrëdhëniet e vendosura mes dy institucioneve dhe u angazhuan në forcimin e mëtejshëm të tyre. Zoti Dervishi e njohu homologen e tij gjermane mbi progresin e bërë nga Shqipëria në fushat e veprimtarisë që mbulon Zyra e Komisionerit. Palët diskutuan mbi mundësinë e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave institucionale në fushën e informimit dhe rritjes së transparencës.

Me qëllim përfitimin e një ekspertize profesionale u diskutua gjithashtu edhe mbi mundësinë e organizimit të një vizite studimore në Autoritetin Federal të Gjermanisë për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Lirinë e Informimit, në funksion të rritjes së mëtejshme të kapaciteteve institucionale dhe zbatimit të standardeve më të mira ndërkombëtare nga ana e Zyrës së Komisionerit.



“Sfidat dhe arritjet në zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumentet zyrtare” (Konventa e Tromsø)”



Konventa e Këshillit të Evropës (KiE) “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, e njohur gjithashtu si Konventa e Tromsø-s, është instrumenti i parë juridik ndërkombëtar që njeh të drejtën e çdo individi për të pasur qasje në dokumentacionin me karakter publik. Në Konferencën e Berlinit u zhvillua një panel i posaçëm në të cilin u shqyrtua ndikimi i Konventës, që nga hyrja në fuqi në vitin 2020, ndërsa u diskutua mbi zbatimin e këtij dokumenti në nivel kombëtar dhe sfidat në garantimin e kësaj të drejte të njeriut.

Zyra e Komisionerit u përfaqësua në këtë panel me znj. Elona Hoxhaj, Drejtore e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit. Ajo ndau me të pranishmit përvojën e vendit tonë në përfshirjen e Konventës së Tromsø-s në legjislacionin shqiptar, duke forcuar kuadrin rregullator në këtë fushë, për zbatimin e standardeve më bashkëkohore në aksesin gjithnjë e më të gjerë në dokumentacionin me karakter publik. Znj. Hoxhaj theksoi përfitimet në forcimin e transparencës dhe të llogaridhënies së institucioneve publike, ndërsa foli mbi sfidat konkrete që hasen në zbatimin e legjislacionit të fushës në praktikën e përditshme administrative. Gjithashtu, në panel u theksua edhe rëndësia e bashkëpunimit ndërkombëtar për të ndërtuar institucione më të hapura dhe të përgjegjshme.

Përveç znj. Hoxhaj paneli përbëhej edhe nga znj. Helena Jäderblom, Presidente e Gjykatës së Lartë Administrative të Suedisë; nga znj. Tetyana Oleksiyuk, Presidente e Grupit të Aksesit të Këshillit të Evropës (Access Info Group - organizmi i ekspertëve teknikë të KiE) dhe z. Attila Péterfalvi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Hungarisë. Diskutimet në këtë panel shërbejnë për nxitjen dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi domosdoshmërinë për ratifikimin e Konventës së Tromsø-s nga sa më shumë vende evropiane dhe jo vetëm, në mënyrë që të promovohet transparenca, llogaridhënia, pjesëmarrja dhe qeverisja demokratike.



Krijohet Rrjeti Evropian për Transparencën dhe të Drejtën e Informimit



Gjatë punimeve të Konferencës së 16-të të ICIC në Berlin u vendos krijimi i Rrjeti Evropian për Transparencën dhe të Drejtën e Informimit (European Network for Transparency and Right to Information - ENTRi). Me institucionalizimin e kësaj platforme, në të cilën institucionet përfaqësuese nga kontinenti ynë u anëtarësuan automatikisht, synohet që të promovohet bashkëpunimi i thelluar dhe strukturuar për promovimin e standardeve më të larta në zbatimin në praktikë të të drejtës për informim. Ky zhvillim pozitiv ka për qëllim forcimin e ndërveprimit institucional dhe nxitjen e shkëmbimit të eksperiencave dhe praktikave më të mira mes autoriteteve homologe evropiane të kësaj fushe.

Vendet anëtare zgjodhën autoritetin federal të Gjermanisë (BfDI) si President të Komitetit Drejtues të Rrjetit ENTRi, forum në të cilin përfaqësohen gjithashtu edhe institucionet e Portugalisë, Spanjës, Francës, Kosovës dhe Skocisë. Veçanërisht, për kolegët e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, kjo është një arritje e rëndësishme në rrugëtimin e tyre për forcimin e rolit të institucionit në arenën ndërkombëtare, për nxitjen e transparencës dhe hapjen e autoriteteve publike në Republikën e Kosovës.

